



KOMPANIA UJËSJIELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D. D.

PRISHTINA

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit

“Prishtina” sh.a.

Njësia Operative e Ujësjiellësit

Lipjan

Për : Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Përmes : Kryesuesit të Kuvendit z. Daut Azemi.

Nga : KUR PRISHTINA - NjOU-Lipjan, menaxher Elmi Bublica.

Vendi : Lipjan.

Datë : 19.02.2020.

Lënda : Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijës në zonën e shërbimit të Komunës së Lipjanit.

Janar 2020

Kompania Rajonale e Ujësjetllësit
“Prishtina” sh.a.

Njësia Operative e Ujësjetllësit
Lipjan

Realizimi i Planit të biznesit
2019

Janar 2020, Lipjan


1. Profili i konsumatorëve

Struktura e konsumatorëve në NJOU në Lipjan është heterogjene. Megjithatë ka një strukturë të favorshme të konsumatorëve, duke u nisur nga fakti se një pjesë e zonës industriale në drejtim të aksit rrugor Prishtinë- Ferizaj është e shtrirë në komunën e Lipjanin përkatësisht nën administrimin e Njesisë së Ujësjetës në Lipjan.

2. Struktura e konsumatorëve në fund të vitit 2019

Në fund të vitit 2019 rreth 91% nga numri total i konsumatorëve të regjistruar janë konsumatorë të amvisërisë, ndërsa 9 % nga joamvisëria. Grafiku i strukturës së konsumatorëve:

Planifikuar 2019






Në bazë të këtyre dy grafikoneve konstatohet se pjesëmarrja e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë është rritur për 1 % më shumë në krahasim me Planin e Biznesit.

3. Përpunimi i ujit të pijes, sasia e ujit të faturuar dhe sasia e ujit pa të ardhura

Gjatë vitit 2019, do të prodhohen 1.892.000 m³ ujë. Kapacitetet prodhuese janë të përqendruara në disa lokacione të ndryshme të organizuar në puse nëntokësore dhe stacione pompimit brenda territorit të komunës së Lipjanit. Sasia e ujit të faturuar do të jetë rreth 1.043.772 m³ përkatësisht 55,17 %. Ndërsa sasia e ujit të humbur pritet të jetë rreth 848.228 m³ përkatësisht 44,83 % e sasisë së ujit të përpunuar.


4. Paraqitja grafike e sasisë së ujit të faturuar dhe sasia e ujit pa të ardhura

Sasia e planifikuar e ujit: përpunuar, faturuar, humbur (m³ dhe %)



Faktike 2019

Sasia faktike e ujit: përpunuar, faturuar, humbur (m³ dhe %)



5. Trendi mujor i sasisë së ujit të përpunuar, ujit të faturuar dhe ujit të humbur (shprehur në m³ dhe %)

Planifikuar 2019

Elementet		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Totali i ujit të prodhuar	m ³	160,690	139,956	155,507	150,323	155,507	155,507	171,058	176,241	160,690	155,507	150,323	160,690	1,892,000
Totali i ujit të faturuar	m ³	85,969	75,296	84,129	81,776	85,062	85,529	94,595	97,990	89,826	87,395	84,933	91,272	1,043,772
Uji pa të ardhura	m ³	74,721	64,660	71,378	68,547	70,445	69,978	76,463	78,251	70,864	68,112	65,391	69,418	848,228
Përqindja e ujit të faturuar	%	53.50%	53.80%	54.10%	54.40%	54.70%	55.00%	55.30%	55.60%	55.90%	56.20%	56.50%	56.80%	55.17%
Përqindja e ujit të afaturuar	%	46.50%	46.20%	45.90%	45.60%	45.30%	45.00%	44.70%	44.40%	44.10%	43.80%	43.50%	43.20%	44.83%

Faktike 2019

Elementet		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Totali i ujit të prodhuar	m ³	202,686	191,994	189,631	191,783	198,032	210,167	198,298	195,714	186,900	184,102	182,208	183,119	2,314,634
Totali i ujit të faturuar	m ³	86,422	84,852	86,069	95,913	92,207	95,245	86,791	92,842	86,854	78,273	82,814	90,577	1,058,859
Uji pa të ardhura	m ³	116,264	107,142	103,562	95,870	105,825	114,922	111,507	102,872	100,046	105,829	99,394	92,542	1,255,775
Përqindja e ujit të faturuar	%	42.64%	44.20%	45.39%	50.01%	46.56%	45.32%	43.77%	47.44%	46.47%	42.52%	45.45%	49.46%	45.75%
Përqindja e ujit të afaturuar	%	57.36%	55.80%	54.61%	49.99%	53.44%	54.68%	56.23%	52.56%	53.53%	57.48%	54.55%	50.54%	54.25%


Në bazë të rezultateve përfundimtare të paraqitura në dy tabelat paraprake konstatojmë se sasia e ujit të prodhuar është më e madhe se sasia e planifikuar për 422.634 m³ ujë përkatësisht 22 %.


6. Të hyrat e faturuara dhe të hyrat e arkëtuara nga shërbimet bazë

- Të hyrat e planifikuara të faturuara nga shërbimet bazë sipas Planit për vitin 2019 janë 686.700 €. Ndërkaq në përfundim të vitit 2019 janë faturuar 675.866 €. Kjo vlerë është më e vogël në krahasim me planin e vitit 2019 për 10.834 € përkatësisht 2 %.
- Të hyrat e arkëtuara gjatë vitit 2019 planifikohen që të jenë rreth 615.958 €, ndërkaq në këtë periudhë janë arkëtuar 591.291 €. Themi se janë arkëtuar 24.667 € më pak në krahasim me planin, respektivisht e shprehur në përqindje 96 % e Planit.

7. Struktura e të hyrave të faturuara nga shërbimet bazë

Pjesëmarrja e të hyrave të faturuara nga shërbimet bazë për sektorin e amvisërisë pritet të jenë rreth 68 %. Gjendja në total është pasqyruar në grafikun si më poshtë.







Nga grafikonet e lartëparaqitur konstatohet se pjesëmarrja e të hyrave nga amvisëria ka rënë për 1 % në krahasim me Planin. Kjo është një tendencë pozitive duke marrë në konsideratë strukturën e tarifimit.

8. Struktura e të hyrave të arkëtuara

Pjesëmarrja e të hyrave të faturuara nga shërbimet bazë për sektorin e amvisërisë pritet të jetë rreth 66 %. Gjendja në total është pasqyruar në grafikun si më poshtë.





Duke analizuar grafikonet e strukturës konstatohet se duke arkëtuar më shumë njëjtë sikurse edhe duke faturuar më shumë për konsumatorët biznesor dhe institucional shkon duke rënë struktura e amvisërisë. Ky në fakt paraqet trend pozitiv.

9. Dinamika e faturimit dhe arkëtimit të shërbimeve

Në tabelën në vijim është paraqitur trendi mujor i faturimit të shërbimeve bazë të klasifikuara sipas kategorisë së konsumatorëve. Gjithashtu njëjtë janë paraqitur edhe dinamika e arkëtimit dhe norma e arkëtimit sipas kategorive dhe në totalet e faturim-arkëtimit.

10. Trendi vjetor i faturimit dhe arkëtimit (shprehur në € dhe %)


Elementet	#	Plani 2019	Janar- dhjetor Faktike	Ndryshimi në %	Ndryshimi në vlerë Faktike-Plani
Uji dhe kanalizimi nga amvisëria	€	463,184	455,730	98%	(7,454)
Uji dhe kanalizimi nga BV	€	74,368	81,013	109%	6,645
Uji dhe kanalizimi nga BM	€	67,311	72,567	108%	5,256
Uji dhe kanalizimi në institucione	€	81,836	66,556	81%	(15,280)
Totali mujor i faturimeve	€	686,700	675,866	98%	(10,834)
-					
Përqindja mesatare arkëtimit nga amvisëritë	%	87%	79.83%	92%	
Përqindja mesatare arkëtimit nga BV	%	93%	104.01%	112%	
Përqindja mesatare e arkëtimit nga BM	%	93%	100.53%	108%	
Përqindja mesatare e arkëtimit nga institucionet	%	100%	105.61%	106%	
Përqindja mesatare totale arkëtimit	%	90%	87.49%	98%	
Arkëtimi mujor nga amvisëritë	€	402,460	363,788	90%	(38,672)
Arkëtimi mujor nga BV	€	69,300	84,262	122%	14,962
Arkëtimi mujor nga BM	€	62,731	72,951	116%	10,220
Arkëtimi mujor nga institucione	€	81,467	70,290	96%	(11,177)
Totali mujor i arkëtimit	€	615,958	591,291	96%	(24,667)


11. Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes

Në bazë të organizimit të tanishëm të kontabilitetit të ndërmarrjes nuk është e mundur të bëhet ndarja e saktë e shpenzimeve të operimit dhe të mirëmbajtjes, duke përfshirë në këtë rast edhe shpenzimet e zhvlerësimit dhe “borxhit të keq”. Këtu janë përfshirë vetëm shpenzimet direkte të operimit dhe të mirëmbajtjes në NJOU në Lipjan, ndërsa shpenzimet indirekte i adresohen njësisë qendrore në Prishtinë.

12. Struktura e shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes

Planifikuara 2019





13. Pasqyra vjetore (panifikuar dhe faktike) e shpenzimeve të operimit dhe të mirëmbajtjes për vitin 2019

Elementet	Planifikuar 2019	Faktike 2018	% Faktike/ Planin	Ndryshimi Faktike- Plani
Vlera ujit te paperpunuar	-	-	0%	-
Shpenzimet e energjise	185,889	187,375	101%	1,486
Shpenzimet e karburanteve	10,167	8,460	83%	(1,707)
Shpenzimet e personelit	459,621	340,975	74%	(118,646)
Shpenzimet materiale	53,062	12,488	24%	(40,574)
Sherbimet e jashtme kontraktuese	14,519	-	0%	(14,519)
Shpenz.dihmave solidare	73	-	0%	(73)
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	806	-	0%	(806)
Shpenzimet e tjera	3,158	1,157	37%	(2,001)
Total shpenzimet operative	727,295	550,455	76%	(176,840)

////////////////////////////////////